

DEKLARATA NËN BETIM

Sipas Nenit 17 të Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike të plotësuara dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike

Unë i nënshkruari, (Emri dhe Mbiemri) _____, **i lindur (data e lindjes)** _____, **në (vendi i lindjes)** _____, që konkuroj për pozitën: _____, dhe deklaroj nën betim se:

1. I përmbushi të gjitha kushtet e Kualifikimit sipas nenit 17.1 të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike të plotësuara dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike:

- a) nuk jam i dënuar ose vendosur nga një gjykatë kompetente, përveç nëse ky dënim ose vendim më pas është ndryshuar nga një gjykatë tjetër në bazë të ankesës, se kam kryer veprë penale ose civile veprë penale apo civile që përfshin përgënjeshtimin, prezantimin e rrejshëm, korrupsionin, vjedhje, pastrimin e parave, përvetësimin, keqpërdorimin apo ndarjen e rrejshme të fondeve, ka qenë i përfshirë në mitosje apo ryshfet sipas ligjeve apo rregulloreve në fuqi në Kosovë apo ndonjë vend tjetër, apo sipas traktateve ose konventave ndërkombëtare;
- b) nuk është vendosur nga një gjykatë ose organ apo organizatë përgjegjëse për zbatimin e kodit etik apo standardeve të sjelljes profesionale, përveç nëse ky dënim ose vendim më pas është ndryshuar nga një gjykatë ose organ tjetër në bazë të ankesës (i) se jam angazhuar në sjellje jo- profesionale, (ii) se kam shkelur kodin etik apo standardet e sjelljes profesionale, (iii) se kam keq-përvetësuar apo kam keqpërdorur paratë apo burimet publike (iv) se kam keq-përdorur apo keq-përvetësuar informatat (të dhënat) e fituara gjatë shërbimit si zyrtar publik apo shërbyes civil, ose (v) se kam keqpërdorur postin publik ose postin në shërbimin civil për përfitime personale ose për përfitime apo përparësi të një të afërmi ose të njohuri;
- c) nuk kam bërë përgënjeshtime material nën çfarëdo dëshmie nën betim apo betimi tjetër, dokumenti të vulosur apo noterizuar;
- d) nuk jam shpallur i falimentuar gjatë dhjetë (10) viteve të kaluara.
- e) nuk punoj në ndonjë institucionin ku bëhen politikat zhvillimore për NP për të cilën konkuroj;

2. I përmbushi të gjitha kushtet e pavarësisë ashtu sikurse parashihet në nenin 17.2 (d), (f), (j), (k), (l) të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike të plotësuara dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike:

- nuk jam aksionar, drejtor, zyrtar ose punonjës i lartë në një shoqëri tregtare ose person tjetër juridik i cili ka marrëdhënie materiale afariste me NP-në për të cilën konkuroj ose cilëndo nga filialet e saj;
- nuk mbaj drejtorësi të ndërsjellë ose lidhje të konsiderueshme me drejtorët e tjerë të NP-së për të cilën konkuroj përmes përfshirjes në shoqëri tjera tregtare ose organe;
- nuk jam (i) punonjës, zyrtar, drejtor ose aksionar, dhe nuk kam asnjë Interes Financiar në një shoqëri tregtare të pa-listuar dhe që konkurron me Ndërmarrjen; (ii) nuk jam menaxher i lartë, zyrtar, drejtor ose aksionar (i cili posedon më shumë se dy për qind (2 %) të drejtave të votimit) ose nuk kam një Interes të konsiderueshëm Financiar në cilëndo nga shoqëritë tregtare të listuara që konkurrojnë me Ndërmarrjen;

- nuk jam dhe brenda 36 muajsh para datës së aplikimit nuk kam qenë zyrtar (i) zgjedhur publik, (ii) i emëruar politik ose (iii) bartës i një posti udhëheqës ose vendimmarrës në një parti politike; (“Zyrtar i zgjedhur publik – nënkupton individin i cili e ushtron një post publik, të cilin e ka fituar përmes zgjedhjeve. “I emëruar politik” - nënkupton personin i cili është emëruar, ose propozuar nga subjekti politik si kandidat për një post të zgjedhur).
- nuk kam asnjë lloj konflikti të interesave që për nga natyra, do të shkaktonte që të mos jem në gjendje që në mënyrë rutinore, me besnikëri, në mënyrë të pavarur dhe objektive t’i përmbushë detyrat e mia financiare ndaj Aksionarëve dhe NP- së.

Nuk ka asnjë përgënjeshtim material – qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca – ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur. Ekzistimi i çfarëdo përgënjeshtimi në të dhënat e kësaj deklarate nënkupton në diskualifikimin tim të menjëhershëm apo largimin nga pozita.

Emri :	Nënshkrimi:
--------	-------------

Prishtinë,

Data: ____/____/_____